



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202002487/4

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2020

**Lënda:** Rekomandim për fuqizimin e familjes së shtetasit L.T. në interesin më të lartë të fëmijëve me inicialet K.T., dhe B.T.

**BASHKISË TIRANË**

**DREJTORISË SË SHËRBIMIT SOCIAL**

**NJËSISË ADMINISTRATIVE NR. 9**

**NJËSISË PËR MBROJTJEN E FËMIJËS**

*Për dijeni:*

**AGJENCISË SHTETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE  
TË FËMIJËS**

**TIRANË**

Të nderuar,

Më lejoni, që nëpërmjet këtij komunikimi, të ndaj me Ju shqetësimin, lidhur me qëndrimin zyrtar të institucionit Tuaj, për me rastin e bërë publik të situatës së vështirë social ekonomike të familjes A.B. dhe djalit të saj madhor L.T. që patsjell shfrytëzimin e fëmijëve me inicialet K.T., dhe B.T., për punë (shesin fara luledielli).

Në mbështetje të nenit 13, të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 "Për Avokati e Popullit, të ndryshuar, Avokati i Popullit filloi procedurën e shqyrtimit të çështjes për familjen B./T., pasi konstatoi shkeljen e të drejtës së jetës, zhvillimit dhe kujdesit shoqëror për fëmijët e kësaj familjeje. Të drejtat janë të

ndërvarura nga njëra-tjetra dhe të patjetërsushme, shkelja e të drejtës së jetës, zhvillimit dhe kujdesit shoqëror si rrjedhojë e problemeve ekonomike, shëndetësore dhe shoqërore passjell edhe shfrytëzimin e fëmijës për punë.

Gjithashtu, në zbatim të shkronjës “b”, të nenit 19, të ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, Avokati i Popullit kërkoi informacion zyrtar<sup>1</sup> nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës, Njesisë Administrative Nr. 9, Tiranë për masat që janë ndërmarrë apo do të ndërmerrnin për trajtimin e rasti në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe, në interesin më të lartë të fëmijës të familjes B./T..

Nga informacioni i gjeneruar zyrtarisht dërguar pranë institucionit të Avokatit të Popullit nga Njësia Administrative nr.9, Bashkia Tiranë rezulton se, familja T. ka probleme ekonomike, shëndetësore dhe shoqërore si më poshtë vijon:

Struktura e familjes “*de-juro*” e fëmijëve me incialet K.T., dhe B.T., përbëhet nga nëna, shtetësja D. T. dhe babai L.T.. Shtetësja A. B. është nëna e z. L.T., pra gjyshja e fëmijëve nga ana e babait, e divorcuar me strukturë familjare më vete. Të dyja familjet, B. dhe T. janë të regjistruar me gjëndje civile në Njesisë Administrative nr.3 Bashkia Tiranë. Aktualisht, familja e L.T. jeton në banesën me qera të znj. B. (nënës së tij), me vendbanim në Njesisë Administrative nr. 9, Bashkia Tiranë.

Familja T. nuk është e përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike, si rezultat i largimit të tyre në Suedi, si azilkërkues, të cilët pas periudhës 3 mujore janë kthyer në Shqipëri. Të ardhurat e familjes janë vetëm pensioni I pleqërisë së nënës së tyre në shumën prej 12 000 lekë (dymbëdhjetë mijë lekë). Banesa në të cilën jetojnë është nga bonusi i qërasë nga Bashkia Tiranë nga znj. A.B.. Gjithashtu, edhe z. T. ka përfituar bonusin e qëras nga Bashkia Tiranë në shumën prej 12 000 lekë (dymbëdhjetë mijë lekë), por vazhdon të jetojë në banesën e nënës së tij.

Nëna e fëmijëve znj.D. T. (në process divorci) edhe, pse i është ofruar këshillim, mbështetje emocionale, punësim nga Njësia e Vleresimit të Nevojave dhe referimit të Rastit ka refuzuar me pretendimin se nuk dëshiron një pagë minimale. Mandej, punonjësit kanë kërkuar të realizojnë një vizitë në shtëpi për vlerësim social-ekonomik më të zgjeruar për identifikimin e problematikave por telefoni rezulton i fikuar dhe rasti është pezulluar nga menaxheri i rastit. Gjithashtu, bashkëshorti I saj ka deklaruar se, gjatë qëndrimit në këtë shtet znj. D. T. ka qenë e shtruar në një spital psikiatrik.

---

<sup>1</sup> Shkresa zyrtare me nr.K5/I36-2 prot. datë 4.5.2020

Babai i fëmijëve, z.T. është i diagnostikuar me një sërë sëmundjesh, si diabet, hepatit etj, Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe referimit të Rastit ka asistuar në përgatitjen e dokumnetacioneve përkatëse për t'u paraqitur pranë KMCAP-it.

Historiku social i familjes B./T. tregon, se zanafilla e problematikave të kësaj familjeje qendrojnë në kushtet e vështira ekonomike të familjes të mbartura ndër vite. Pikërisht, përvec problematika të shtuara në këtë familje sociale, shëndetësore etj, ky është faktori kryesor që patsjell neglizhimin e fëmijëve me inicialet K.T., dhe B.T., dhe shfrytëzimin e tyre për punë.

Nga analiza e veprimeve të kryera nga Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rastit në Njësinë Administrative nr.9 konstatojmë, se masat e ndërmarra janë të foksuara në përfshirjen e familjes në programet e mbrojtjes sociale, bonus qeraje, përfitimi i pagesës së cash si pagesa e aftësisë së kufizuar, punësimin e nënës etj duke vlerësuar nevojat e individit (nënës dhe babait) në bashkëpunim edhe me Njësinë Administrative nr.3 Tiranë. Por, informacioni për vlerësimin e fëmijëve është i pamjaftueshëm dhe i kufizuar. Kërkuam informacion për dy të mitur të cilët shfrytëzohen për punë për të garantuar të ardhura për familjen e tyre dhe, na jepet informacion që fëmijët janë të veshur mirë dhe ndjekin rregullisht shkollën.

Shqetësimi i institucionit të Avokatit të Popullit vazhdon të qendrojë në fragmentizimin e punës nga strukturat përgjegjëse për zbatimin korrekt të legjislacionit për të patur një vlerësim gjithëpërfshirës, të detajuara, të shtrirë në kohë, por edhe në realitetin aktual. Mos përshirja e këtyre elementëve detyrimisht sjell një vlerësim të cunguar të nevojave reale për zgjidhje dhe, si rrjedhojë edhe masat do të jenë të kufizuara. Gjithashtu, mungesa e tipologjive të reja të shërbimeve sociale, të cilat mundëojnë progresin e familjes me në qendër fëmijët janë të fokusuara vetëm brenda kornizave të programeve të mbrojtjes sociale duke sjell regres dhe nxitur problematikat që ndikojnë në shkeljen e të drejtave të fëmijëve.

Për sa më sipër, institucioni i Avokatit të Popullit konstaton, se informacioni zyrtar dërguar nga Njësia Administrative nr. 9 Tiranë është mbështetur vetëm në vlerësimin e situatës social-ekonomike të familjes, si dhe masave të ndërmarra përfshirjen e kësaj familjeje në programet e mbrojtjes sociale, programe pasive, të cilat nuk ndihmojnë dhe nxisin familjen për t'u integruar dhe fuqizuar me qëllim për të garantuar mirëqenien e fëmijëve. Pikërisht, për të mos krijuar varësi nga këto skema pasive është bërë e mundur përmirësimi i kuadrit ligjor me qëllim që familjeve në nevojë t'ju krijohet mundësia për integrimin e tyre, nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrësh e shërbimesh për përmirësimin e jetesës së tyre nga aktor të ndryshëm shtetëror dhe jo-

shtetëror.

Konkretisht:

- Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës duhet të zbatojë korrekt në praktikë detyrat e përcaktuara në nenin 51, të ligjit nr.18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” për të identifikuar në mënyrë proaktive rastet e fëmijës në rrezik dhe në nevojë për mbrojtje, nëpërmjet vizitave periodike në terren dhe në familjen e fëmijës në rrezik, komunikimit me profesionistët nga sektori i arsimit, shëndetësisë dhe rendit, të cilët kanë kontakte me fëmijët, të bëjnë vlerësimin e nivelit të rrezikut të çdo rasti të referuar dhe të identifikuar të fëmijës në nevojë për mbrojtje, të bashkëpunojnë dhe të shkëmbejnë informacion, për menaxhimin e rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje, me çdo strukturë përgjegjëse shëndetësore, arsimore, policore, të prokurorisë dhe të gjyqësorit, në nivel qendror dhe vendor, si dhe me shoqërinë civile, duke ruajtur të dhënat personale të fëmijës, për të bërë të mundur fuqizimin e familjes.

Në këtë kuptim, në funksion të zbatimit korrekt të kuadrit të ri ligjor të miratuar, për mbrojtjen e fëmijës, fuqizimit të familjes, programeve gjithëpërfshirëve me tipologji të reja të shërbimeve sociale duke bashkëpunuar, bashkërenduar dhe koordinuar punën ndërsektoriale në nivel qendror dhe vendor, në interesin më të lartë të fëmijës, institucioni i Avokatit të Popullit, në mbështetje të neneve 21 dhe 24, të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999, ”Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar,

### **REKOMANDON:**

- Marrjen e masave nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës për të bërë të mundur vlerësimin e nevojave të fëmijëve të familjes B./T. dhe hartimin e planit të mbrojtjes për të siguruar një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe gëzimin e një jetese normale e pa privime.
- Marrja e masave nga Bashkia Tiranë për të ofruar tipologji të reja të shërbimeve sociale, për të bërë të mundur progresin e familjeve (që mbartin probleme ekonomike ndër vite) me në qendër fëmijët me qëllim garantimin e mbrojtjes së tyre dhe parandalimin e neglizhimit dhe shfrytëzimit të fëmijëve për punë.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454 datë 4. 2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar

rekomandime, duhet t'i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit.

Duke Ju falënderuar për miëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, lutemi shqyrtimin e këtij rekomandimi.

Duke Ju falënderuar,

**K O M I S I O N E R**

**Nejla PEKA**

Konceptoi: M.Tyli